

TESTI PROVUES I MATURËS

UDHËZIM PËR KONTROLLIMIN E TESTIT

GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE

UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

1. Numri i pikëve për secilën detyrë, ose pyetje është i dhënë në tabelë.
2. Nëse është e saktë vetëm një pjesë e përgjigjes, përgjigja vlerësohet me zero (0) pikë.
3. Nëse nxënësi jep dy përgjigje, prej të cilëve njëra nuk është e saktë dhe nuk është mirë e saktësuar si e tillë (dmth. e përmirësuar duke i rënë vizë përgjigjes së gabuar), përgjigja vlerësohet me zero (0) pikë.
4. Përshkrimet e palexueshme dhe përmirësimet e paqarta vlerësohen me (0) pikë.
5. Nëse përgjigja në aspektin gramatikor dhe drejtshkrimor është në rregull, por me të nxënësi nuk ka dhënë përgjigje në pyetje, përgjigja vlerësohet me (0) pikë.
6. Nëse nxënësi nuk ka respektuar udhëzimet për zgjidhje të detyrave (p.sh. ka rrethuar më shumë përgjigje sesa janë kërkuar), ajo përgjigje vlerësohet me (0) pikë, ose në përputhje me udhëzuesin për vlerësim (dmth. poentim) që është dhënë në tabelë për detyrën e caktuar.
7. Nëse nxënësi përgjigjen në detyrë e vendos në një mënyrë tjetër (p.sh. nënvizon në vend se të rrethoj), një përgjigje e tillë ashtu e vendosur vlerësohet në përputhje me udhëzuesin për vlerësim (dmth. poentim).
8. Në deklarin e përgjigjes kllapat nënkuptojnë se përgjigja është e saktë edhe pa !alë në kllapa.
9. Në deklarin e përgjigjes, thyesa (/) nënkupton zgjidhje alternative.
10. Për përgjigje të shkurtëra pa shenja të pikësimit pikët nuk iu merren.
11. Në rast të shumë përgjigjeve të sakta, në tabelë e para jepet përgjigja që kërkohet dhe më pas jepen edhe përgjigjet tjera të sakta.

Detyra 1.

numri i pikëve: 1

lidhëz,

1 pikë

Detyra 2.

numri i pikëve: 1

Do të vij me ju në kinema.

1 pikë

Detyra 3.

numri i pikëve: 1

parashtesim

1 pikë

Detyra 4.

numri i pikëve: 1

Shkollatë profesionale

1 pikë

Detyra 5.

numri i pikëve: 1

Naim Frashëri

1 pikë

Detyra 6.

numri i pikëve: 1

| | Kështjella | Lutjet e mbrëmjes | Malësorja | Nita |
|----------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| Nazmi Rrahmani | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Ismail Kadare | <input checked="" type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Josip Relja | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> |
| Anton Pashku | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |

1 pikë

Detyra 7.

numri i pikëve: 1

| | |
|----------------------------------|-------|
| <input checked="" type="radio"/> | sonet |
|----------------------------------|-------|

1 pikë

Detyra 8.

numri i pikëve: 1

| | |
|----------------------------------|-------------|
| <input checked="" type="radio"/> | Romantizmit |
|----------------------------------|-------------|

1 pikë

Detyra 9.

numri i pikëve: 2

Pjesët e ndryshueshme të ligjëratës janë: Emri Mbiemri, Përemri, Numërori dhe Folja.

5 përgjigje 2 pikë

4 përgjigje 1 pikë

Detyra 10.

numri i pikëve: 1

 dialektin toskë

Cdo përgjigje e sakte ka 1 pike

Detyra 11.

numri i pikëve: 1

 b, p, m

1 pike

Detyra 12.

numri i pikëve: 2

Trajta e pashquar
Rasa kallëzore,
Numri shumës,
Gjinia mashkullore

4 përgjigje të sakta 2 pikë

3 përgjigje të sakta 1 pikë

Detyra 13.

numri i pikëve: 1

 mbaresë

1 pikë

Detyra 14.

numri i pikëve: 2

Arkaizma : heshtë,sokak,gravatë,shkronjë,hekur
Huazime: aksham,jeniçer,asfalia,program
Neologjizma: topçi, përditësoj, dyrrotak ,ikanak, mëmëvrasje

Përgjigje e plotë 2 pikë

10, 11,12 dhe 13 përgjigje 1 pikë

Më pak se 10 përgjigje 0 pikë

Detyra 15.

numri i pikëve: 2

Përgjigje e pranueshme

Strofa 1 Autori dëshiron të jetë pranë atyre që u drejtohet 'duke u përvëlur', pra duke punuar dhe duke e ndarë diturinë dhe veprën e vete me të tjerët, me qëllim që edhe ata të fitojnë një thërrimë të asaj urtësie që është ideal për të mos jetuar në errësirën e injorancës.

Përgjigje e plotë 2 pikë

Përgjigje e pjesshme 1 pikë

Detyra 16.

numri i pikëve: 1



Teorisë së letërsisë

1 pikë

Detyra 17.

numri i pikëve: 1



e përmbyllur

1 pike

Detyra 18.

numri i pikëve: 1



sonet

Përgjigje e saktë 1 pikë

Detyra 19.

numri i pikëve: 2

Përgjigje e pranueshme

- Në kuadër të formimit të shtetit shqiptar, lindi nevoja e formimit të një alfabeti të vetëm dhe te njesuar te gjuhes shqipe me 36 shkronja.
- Në nëntor të vitit 1908, në Kongresin e Manastirit u vendos për alfabetin e gjuhës shqipe me bazë latine që kemi dhe sot. Kryetar i Kongresit të Manastirit ne vitin 1908 u zgjodh At Gjergj Fishta,

përgjigje e plotë e saktë 2 pike

përgjigje vetëm e pjesës së parë 1 pikë

Detyra 20.

numri i pikëve: 2

Unë shkova pranë tij – jokalmtare

Thërras me forcë – jokalmtare

Shkova dorën në flokë – kalimtare

Thërras shoqen time – kalimtare

Fjeta gjatë – jokalmtare

E fjeta mendjen – kalimtare

Kaloj klasën – kalimtare

Humba në mendime – jokalmtare

Humba rrugën - kalimtare

Kaloj rrugës – jokalmtare

Mbi tetë përgjigje të sakta 2 pikë

Mbi gjashtë përgjigje të sakta 1 pikë

Detyra 21.

numri i pikëve: 1



kallëzues emëror

1 pikë

Detyra 22.

numri i pikëve: 1

 të gjitha së bashku.

1 pikë

Detyra 23.

numri i pikëve: 2

| Gjykimi | PO | JO |
|-----------------------------------------------------------------|----------------------------------|----------------------------------|
| Epika sugjeron dhe evokon ndjenja dhe emocione. | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> |
| Poezia epike shkruhet në monokolonë. | <input checked="" type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Poezia epike e merr lëndën e vet nga historia. | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> |
| Heronjtë epikë janë heronj që luftojnë për interesat personale. | <input type="radio"/> | <input checked="" type="radio"/> |
| Poema epike ka elementin fantastik. | <input checked="" type="radio"/> | <input type="radio"/> |

Përgjigja e plotë 2 pikë, ndërsa katër detyra 1 pikë.

Detyra 24.

numri i pikëve: 2

Zgjidhja: Rrëfimtari : Demkoja(nëpunës)

veta e rrëfimit: veta e parë

a është i njejtë rrefimtari me autorin? pse? - jo, rrëfimtari është peronazh, ndërsa autori shkrimtari.

- 3 Përgjigje 2 pikë
- 2 Përgjigje 1 pikë
- 1 Përgjigje 0 pikë